- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERËSIMI

(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Dokumenta Standarde të Tenderit

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/ Bashkimit të operatorëve NIPTET/ Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;
- g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriteve të Pergjithshme të Pranim/Kualifikimit, pika 1 e shtojcës 12.

*Shenim 2.1.1:

Ne rastin e kontratave të bashkepunimit, Autoriteti Kontraktor do të kryejë pagesa vecmas cdo operatori ekonomik sipas përqindjes që ka marrë persiper për punimet që do të realizojë në kontratën e bashkepunimit. Detyrimisht kontratat e bashkepunimit të paraqiten në përputhje me këtë shenim.

*Shenim 2.1.2:

Operatorët ekonomik duhet të deklarojnë nëse do të nenkontraktjnë një apo disa punime një operatori ekonomik në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Nuk do të pranohen nenkontraktor të padeklaruar në fazën perkatese sipas percaktimeve ligjore në fuqi. Nëse gjatë zbatimit të punimeve do të hasen nenkontraktor të pa deklaruar O.E. fitues do të jete pergjegjes per penalitetet ligjore ne perputhje me LPP.

2.2 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- a. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit duhet të mos jete me e vogel se 50 % e fondit limit. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit.
- b. OE të paraqesë kopje të bilanceve të viteve 2017-2018-2019, të konfirmuara nga autoriteti përkatës, të shoqeruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin nr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesi tligjor dhe kontabilistit të miratuar”
- c. Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2019 në të gjitha adresat ku operatori/operatorët ekonomik ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhenave perkatese te ekstraktit te QKR-se

2.3 Per kapacitetin teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Punë të ngjashme e realizuar ne një kontrate te vetme ne nje vlere jo me e vogel se 50 % e fondit limit, te realizuar gjatë tri viteve (nga data e afatit te dorezimit te ofertave deri ne 3 vite para ketij afati) të fundit ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit (nga data e afatit te dorezimit te ofertave deri ne 3 vite para ketij afati),ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) Kontraten/at e Sipërmarrjes,
- b) Situacion përfundimtare të objektit,
- c) Faturat tatimore për çdo situacion,
- d) Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojces nr.8.
- e) Akti i Kolaudimit
- f)*Kontrata e bashkepunimit ndermjet O.E ku te jete e perfshire marreveshja e ndarjes se punimeve mes paleve.

Shenim 2.3.1:

Pika f) te paraqitet per kontrata te ngjashme te realizuara si bashkim operatoresh. Kjo kerkese vjen si arsye per AK per te patur nje vleresim sa me te drejt per punimet dhe zerat e realizuar ne kontrata te ngjashme. Detyrimisht nga OE pjesemarrës ne kete procedure duhet te paraqitet kontrata e bashkepunimit.

Ne rast te mos paraqitjes do te jete kusht mos pranimi si pune e ngjashme.

Shenim 2.3.2:

Per kontrata te ngjashme te realizuara ne rolin e nenkontraktorit, detyrimisht te paraqitet:

- Deklarimi i O.E./B.O.E. fitues ne procedure perkatese per caktim te nenkontraktorit;
- Konfirmimi i nenkontraktorit nga AK, me zerat perkates te punimeve/sherbimeve/mallrave qe ka marre persiper per terealizuar;
- Kontrata mes Autoritetit Kontraktor dhe O.E. ne cilesine si nenkontraktor;
- Formularin e vleresimit per realizimin e punimeve/sherbimeve/mallrave qe ka realizuar me sukses si dhe;
- Faturat tatimore te shoqeruara me Situacionet e nenshkruara nga mbikqyres i ipunimeve;

Për kontrata për punë private të realizuara me subjekte private kërkohen:

- a) Kontraten/at e Sipërmarrjes,

Dokumenta Standarde të Tenderit

- b) Situacion përfundimtare të objektit,
 - c) Faturat tatimore për çdo situacion,
 - d) Formular Vleresimi nga Investitori.
 - e) Akti i Kolaudimit
3. Liçenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontrates, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë:

NP-1 A	Punime germimi ne toke
NP- 7 C	Ujesjellesa, vajsjellesa, gazsjellesa, vepra kullimi e ujitje
NP-12 A	Punime te inxhinierise se mjedisit
NS - 18 A	Punime topogjeodezike

4. Drejtues Teknik ne licencen e Shoqërisë të ketë në përbërje:

1) Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
2) Inxhinier Ndertimi	2 (dy)
3) Inxhinier Topograf	1 (nje)
4) Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
5) Inxhinier Mekanik	1 (një)
6) Inxhinier Elektrik	1 (një)

Per sa me siper O.E. pjesemarres te paraqes:

- Kontrata noteriale individuale per secilin nga drejtuesit teknik;
 - Diplomen perkatese;
 - 1 (nje) nga drejtuesit e mesiperm duhet te jete i pajisur me certifikate per sigurine dhe shendetin ne pune. Te paraqitet certifikata e trajnimit/kualifikimit perkatese e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi kombetar dhe/ose nderkombetar.
 - Drejtuesit teknike duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë për një periudhë jo më pak se një vit. Te paraqiten listepagesat perkatese te shoqerise E-sig per periudhen e siperpermendur per 12 muajt e fundit perkatese nga data e mbylljes se tenderit si dhe vertetimi elektronik mbi pagesen e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore te leshuar nga E-albania
5. Krahas stafit te mesiperm operatori ekonomik duhet te kete te punësuar minimalisht punonjes te diplomuar/certifikuar, si me poshte:

-Inxhinier topograf - 2 (dy)

-Inxhinier inspektor per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015 - 1(nje)

-Inxhinier ndertimi/arkitekt pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune -2 (dy)

-Inxhinier pergjegjes per demet ne mjedis - 1(nje)

-Inxhinier pergjegjes per auditimin e energjise - 1(nje)

-Specialist te ndihmes se pare -2 (dy)

-Teknik ndertimi - 5 (pese)

- Mekanik - 2 (dy)

-Hidraulik -3 (tre)

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Karpentier - 5 (pese)
 - Manovratorë - 10 (dhjete)
 - Shofer - 9 (nente)
 - Saldator - 3 (tre)
 - Hekurkthyes - 5 (pese)
 - Punetore te thjeshte - 50 (pesedhjete)
- Per stafin e mesipermtë paraqitet kontrate pune perkatese si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin.
 - Per stafin e mesipermtë te kerkuar me profesionin inxhinier te paraqitet, kontrate e punes, diploma univeristare, deshmia e specializimit dhe cv.
 - Per punetore te thjeshte te paraqitet kontrate pune perkatese.
 - Punonjesit e mesipermtë te figurojne minimalisht ne tre muajin e fundit ne liste pagesat e shoqerise (muaji Maj, Qeshor, Korrik 2020). Per kete arsye te paraqiten listepagesat perkatese te nenshkruara elektronikisht nga sistemi e- Albania si dhe urdher pagesa perkatese qe konfirmon kryerjen e pagesave perkatese mujore.si
6. Te kete te punesuar mjekun e shoqerise. Te paraqes kontrate pune noteriale, diplome, si dhe license (urdhri i mjekut).
7. Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion me kapacitet mbajtes minimalisht 10 ton	Copë	13	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes minimalisht 1 ton	Copë	5	Në pronësi ose me qira
3	Fadroma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Eskavator	Copë	8	Në pronësi ose me qira
5	Eskavator krahe gjate min. 18 m	Copë	2	Në pronësi ose me qira
6	Autovinc	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Autopompe betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qira
8	Autobetoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qira
9	Autobot uji	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Greider	Copë	3	Në pronësi ose me qira
11	Rrul	Copë	3	Në pronësi ose me qira
12	Rimorkiator	Copë	2	Në pronësi ose me qira
13	Koke terheqese	Copë	2	Në pronësi ose me qira
14	Saldatriçe	Copë	2	Në pronësi ose me qira
15	Karroca dore	Copë	10	Në pronësi ose me qira
16	Kokore	Copë	100	Në pronësi ose me qira
17	Jelek	Copë	100	Në pronësi ose me qira
18	Doreza pune	Copë	100	Në pronësi ose me qira
19	Tabela	copë	10	Në pronësi ose me qira
20	Tranxh	copë	1	Në pronësi ose me qira

Dokumenta Standarde të Tenderit

21	GPS	copë	1	Në pronësi ose me qira
22	Kompaktor ngjeshes	copë	3	Në pronësi ose me qira
23	Pajisje per bashkim tubash	copë	2	Në pronësi ose me qira
24	Betoniere	copë	5	Në pronësi ose me qira
25	Vibrator betoni	copë	5	Në pronësi ose me qira
26	Nyje betoni dhe inerte	copë	1	Në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi
27	Fabrike prodhim rere	Cope	1	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi
28	Fabrike prodhim hekuri	Cope	1	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi
29	Pirun teleskopik	Cope	1	Në pronësi ose me qira
30	Vinc eskavator me graifer hidraulik	Cope	1	Në pronësi ose me qira
31	Sonde shpimi	Cope	2	Në pronësi ose me qira

- a) Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noteruar.
- b) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje noteriale, si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e noteruar).
- c) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të jetë e shtrirë brenda afatit të realizimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- d) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar.
- e) Per fabriken e betonitinerëve, dhe hekurit, ne jane ne pronesi te paraqitet leje mjedisore e vlefshme. Nese keto fabrika nuk jane ne pronesi te operatorit ekonomik te paraqitet kontrate qiraje ose kontrate/autorizim furnizimi mes paleve, si dhe licenca perkatese mjedisore e vlefshme.
- f) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk do të jene të angazhuara në kontrata të tjera gjate kohes se zbatimit te kesaj kontrate.

Shenim 8.1:

Per te konfirmuar disponibilitetin e mjeteve te marra me qira te paraqiten si me poshte:

1. Kontrate noteriale qiraje/huaperdorje me emer objekti dhe me afate te percaktuar te cilat do te jene ne dispozicion deri ne realizimin e punimeve dhe / ose;
 2. Kontrate noteriale qiraje/huaperdorje pa afat te percaktuar por te jene te shoqeruara detyrimisht dhe mandat pagesat bankare per secilin nga automjetet dhe/ose pajisjet e marra me qira.
- 8- Operatori ekonomik duhet te kete kontrate noteriale me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve.
- 9- Operatori ekonomik duhet te kete kontrate noteriale per stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme, i cili duhet te jete i licensuar me leje mjedisore nga Qendra Kombetare e Licencimit sipas Kodit III.1.A.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 10- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.
- 11- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje për masat e mbrojtjes nga zjarrilëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi I.2.A.
- 12- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore për auditim mjedisor lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi III.2.A
13. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” /ekuivalente dhe e vlefshme.

OHSAS 18001:2007 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë” /ekuivalente dhe e vlefshme.

ISO 14001:2004 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” /ekuivalente dhe e vlefshme.

PAS 99:2012 mbi “Sisteme të menaxhimit të integruar” /ekuivalente dhe e vlefshme.

ISO 1452-1:2009 mbi “Ndertimi dhe mirëmbajtja e rrugeve , ndërtesave ujeshjelles-kanalizimeve” /ekuivalente dhe e vlefshme.

ISO IEC 27001: 2013 mbi “Ndertimi dhe mirëmbajtja e rrugeve , ndërtesave ujeshjelles-kanalizimeve” /ekuivalente dhe e vlefshme.

ISO 50001 :2011 mbi “Ndertimi dhe mirëmbajtja e rrugeve , ndërtesave ujeshjelles-kanalizimeve” /ekuivalente dhe e vlefshme.

ISO 28001:2007 mbi “Ndertimi dhe mirëmbajtja e rrugeve , ndërtesave ujeshjelles-kanalizimeve” /ekuivalente dhe e vlefshme.

ISO 39001 :2012 mbi “Ndertimi dhe mirëmbajtja e rrugeve , ndërtesave ujeshjelles-kanalizimeve”

UNI EN ISO 3834: 2006 mbi “Ndertimi dhe mirëmbajtja e rrugeve , ndërtesave ujeshjelles-kanalizimeve” /ekuivalente dhe e vlefshme.

Shenim:

Ne rast se në preventivin e publikuar në SPE rezultojnë mallra me emër markë/brand O.E. të paraqesin produkte ekuivalente në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

O.E. të paraqes deklaratë garancie jo më pak se 1 vit nga momenti i marrjes në dorëzim. Çdo dokument duhet të jetë origjinal, në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe noterizuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkëlqje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit te punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshme qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezyrtueshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porosinë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

